

Kontakt i studimit (Angli): IQVIA **0800 085 6807**
Kontakt i studimit (Uells): IQVIA **0800 917 9323**
Kontakt i studimit (Irlanda e Veriut): IQVIA **0800 917 5825**
Kontakt i studimit (Skoci): IQVIA **0800 917 5824**

Anketa e Infeksionit COVID-19

Merrni pjesë në anketën më të madhe në mbarë vendin për infeksionet e COVID-19 në të kaluarën dhe të tashmen. **Mbështetja juaj do të ndihmojë në udhëzimin e reagimit ndaj kësaj pandemie, për t'i kthyer të gjithë në jetën normale.**

Për çfarë është anketa?

- Qëllimi i anketës është të gjejë se sa njerëz kanë COVID-19, me ose pa simptoma.
- Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi më shumë njerëz fillojnë të vaksinohen ndaj COVID-19. Megjithëse vaksinat funksionojnë shumë mirë, ato nuk i ndalojnë plotësisht njerëzit që të marrin virusin përsëri edhe nëse e kanë pasur COVID-19 në të kaluarën. Ne duhet të monitorojmë se sa mirë funksionojnë vaksinat në botën reale dhe sa mirë kombinimi i njerëzve që kanë pasur COVID-19 më parë edhe që vaksinohen ndalon përhapjen e virusit.
- Anketa gjithashtu synon të zbulojë se sa njerëz mund të kenë pasur më parë COVID-19. Kjo bëhet duke matur nivelet e antitropave në gjakun e tyre.
- Që nga prilli i vitit 2020, Zyra për Statistikat Kombëtare dhe Universiteti i Oksfordit kanë kryer anketën në emër të qeverive të MB-së.



Përmbledhje e studimit

Anketa e Infeksionit COVID-19 | Versioni 7.0 Data: 1 shkurt 2021

Ref. e etikës: 20/SC/0195 | IRAS Project ID: 283248

Hulumtuesja kryesore: Profesoreshë Ann Sarah Walker

Përse më është kërkuar që të marr pjesë?

- Për të ndihmuar luftën e vazhdueshme ndaj koronavirusit ne kemi nevojë për familje si e juaja për t'u bashkuar me mijëra që tashmë marrin pjesë në anketën e Infeksionit COVID-19.
- Ne nuk po testojmë thjesht njerëz që kanë shenja të prekjes nga virusi, si ethe ose kollë, pasi e dimë që ndonjëherë njerëzit mund ta marrin virusin pa simptoma.
- Marrja pjesë në këtë studim varet vetëm prej jush. Të gjitha informacionet që na jepni mbrohen nga ligji dhe trajtohen si konfidenciale.
- Gjithkush në studim mund të marrë një vaksinë COVID-19 kur ka të drejtë ta bëjë - dhe njerëzit që kanë marrë një vaksinë COVID-19 mund të jenë në anketim.

Çfarë përfshin studimi?

- **Së pari do të duhet të regjistroheshi për të marrë pjesë (ju lutemi shikoni faqen tjetër),** e pas kësaj do të kontaktoheni për të caktuar një takim.
- Në këtë takim, një anëtar i ekipit të anketës do të vijë në shtëpinë tuaj. Ata do të bëjnë disa pyetje në lidhje me secilin person mbi moshën 2 vjeç që dëshiron të marrë pjesë.
- Ata do t'u tregojnë atyre që janë 12 vjeç e lart se si të marrin mostrat e fytit dhe hundës që do të testohen për virusin. Tamponi është një sfungjer i butë në një shkop dhe nuk shkakton dhimbje. Prindërit ose kujdestarët mund t'i ndihmojnë personat nën 12 vjeç.
- Ne gjithashtu do të dëshironim të merrnim një sasi gjaku nga kushdo që është 16 vjeç ose më i madh. Nuk jeni të detyruar të bini dakord për këtë. Gjaku ose do të merret drejtpërdrejt nga një venë nga një anëtar i ekipit të trajnuar të anketimit me PPE, ose nga një shpim gishti të bërë nga vetë personi. Anëtari i ekipit të studimit nuk do të hyjë në shtëpinë tuaj nëse nuk ka nevojë të marrë gjak nga vena.

Ju mund të pranoni:

- A** vetëm vizitën e parë
- B** vizitën e parë dhe një vizitë çdo javë për një muaj (5 vizita gjithsej)
- C** vizitën e parë, një vizitë çdo javë për një muaj dhe më pas mujore deri në prill 2022 (të paktën 16 vizita në total, në varësi të kohës kur i bashkoheni anketimit)

Pse duhet të marr pjesë?

- Koronavirusi vazhdon të na ndikojë të gjithëve. Së bashku ne mund të sigurojmë informacion jetik për të ndihmuar në udhëzimin e përgjigjes ndaj kësaj pandemie, për t'u kthyer në jetën normale.
- Një panoramë e shpejtë dhe e besueshme e infeksioneve në zonën tuaj do të ndihmojë të sigurohemi që përgjigjet lokale janë të përshtatshme dhe të efektive.
- Në periudhën 2021 dhe 2022, mijëra familje do të marrin pjesë në anketë. Kjo do të bëhet në mënyrë që ne të mund të shohim se çfarë ndodh me virusin gjatë kësaj kohe, veçanërisht pasi më shumë njerëz vaksinohen.
- Rezultatet tashmë janë publikuar në mënyrë që ta dinë të gjithë se çfarë kemi konstatuar (www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/results). Asnjë nga këto informacione nuk ju identifikon ju ose familjen tuaj.

Si të merrni pjesë:

Për të marrë pjesë do të duhet të regjistroheni me ne sa më shpejt të jetë e mundur:

- 1** Telefononi ekipin e regjistrimit **0800 085 6807 (Angli), 0800 917 9323 (Uells), 0800 917 5825 (Irlanda e Veriut), 0800 917 5824 (Skoci)** Nëse nuk jeni në gjendje të përdorni telefonin, për shembull për shkak të dëmtimit të dëgjimit ose të të folurit, mund të dërgoni email tek iqvia.covid19survey@nhs.net. 
- 2** Pasi të regjistroheni, hera tjetër që do të dëgjoni nga ne është kur një anëtar i ekipit të anketës t'ju kontaktojë mbrëmjen para vizitës tuaj të planifikuar. Nëse kjo kohë nuk është e përshtatshme për ju, mund ta ndryshoni. Ne do të përpiqemi t'ju kontaktojmë brenda javës pasi të regjistroheni. 
- 3** Ditën e takimit, një anëtar i ekipit të anketës do të vijë në shtëpinë tuaj për të bërë vizitën. Çdo anëtar i ekipit që merr gjak nga një venë do të jetë i kualifikuar për ta bërë këtë. Ju lutemi mos e ftoni anëtarin e ekipit të studimit në shtëpinë tuaj nëse nuk marrin gjak. 
- 4** Në shenjë vlerësimi, **të gjithëve që plotësojnë anketën do t'ju ofrohet një kupon prej 50 sterlina.** 

Çfarë mund të përfitoj nëse marr pjesë?

- Çdo person që merr pjesë në anketë do të marrë një kupon prej 50 sterlina për vizitën e parë që ju bëhet në shtëpi.
- Për çdo vizitë të mëtejshme që kryhet, secili do të marrë një kupon prej 25 sterlina.

Këto do të jenë vetëm për vizitat që janë kryer; për shembull, nëse studimi ndërpritet, ju nuk do të merrni kompensim për vizitat që nuk bëhen.

Çfarë do të ndodhë me të dhënat e mia?

- Të gjitha informacionet që na jepni mbrohen nga ligji dhe trajtohen si konfidenciale.
- Të gjithë mostrat mblidhen në emër të Zyrës për Statistikat Kombëtare dhe Universitetit të Oksfordit.
- I gjithë testimi i këtyre mostrave bëhet nga Universiteti i Oksfordit dhe laboratorët kombëtarë të Lighthouse.
- Juve do t'ju thuhet rezultatet e të gjitha testeve që keni kryer.
- Kompanitë e përfshira në kryerjen e anketës do ta përdorin informacionin tuaj vetëm për qëllimin e kësaj ankete – **ju lutemi shikoni Fletën e Informacionit të Pjesëmarrësit për detaje të mëtejshme.**

Informacione të mëtejshme dhe faqe interneti të dobishme:

Disa përkthime të kësaj përmbledhjeje dhe informacione të tjera të anketës janë në dispozicion në <https://www.ons.gov.uk/surveys/informationforhouseholdsandindividuals/householdandindividualsurveys/covid19infectionsurvey/cis/furtherhelp#study-materials-in-other-languages>

Për të mësuar më shumë, shihni fletën e hollësishme të informacionit për pjesëmarrësin, që është bashkëngjitur me këtë broshurë ose vizitoni www.ons.gov.uk/cis ose www.gov.wales/covidinfectionsurvey

Nëse prekeni nga ndonjë prej çështjeve të ngritura në këtë broshurë ose jeni duke kërkuar informacion mbi COVID-19, ju lutemi vizitoni:

- Shpjegimi mbi Koronavirusin: coronavirusexplained.ukri.org/en/
- Udhëzimet e qeverisë: www.gov.uk/coronavirus (Angli), www.gov.wales/coronavirus (Uells), <https://www.nidirect.gov.uk/campaigns/coronavirus-covid-19> (Irlanda e Veriut), <https://www.gov.scot/collections/coronavirus-covid-19-guidance/> (Skoci)
- Këshilla nga NHS: <https://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/> (Angli), www.gov.wales/coronavirus (Uells), <https://www.nidirect.gov.uk/articles/coronavirus-covid-19-overview-and-advice> (Irlanda e Veriut), <https://www.nhsinform.scot/illnesses-and-conditions/infections-and-poisoning/coronavirus-covid-19> (Skoci)

- Samaritans - Mbështetje emocionale për të gjithë: www.samaritans.org
- Mind - Këshilla dhe mbështetje për këdo me një problem të shëndetit mendor: www.mind.org.uk